

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e shtatëmbëdhjetë e Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale

Mbledhja e Komisionit u mbajt me 13.09. 2023

Në mbledhje morën pjesë:

- 1.Mirheta Gaçeviq, kryetare;
- 2.Veron Halili, anëtar;
- 3.Admir Adroviq, anëtar;
- 4.Tripo Matijeviq, anëtar

Anëtarët Ivana Krushçiq dhe Frashër Selimaj nuk morën pjesë në mbledhje për shkaqe të obligimeve të mëparshme, për ç'gjë e kishin njoftuar kryetaren e Komisionit.

Krahas anëtarëve të cekur të Komisionit, në mbledhje mori pjesë edhe Ballsha Miliq, sekretar i Komisionit, i cili këtë, funksion e mori nga sekretari i deritashëm i Komisionit, Ivan Lekoviq.

Në mbledhje u miratua

RENDI I DITËS

1. Diskutim dhe deklarim lidhur me Procesverbalin nga mbledhja e pesëmbëdhjetë e rregullt e Komisionit;
2. Analizat dhe komentet për ndryshimin e Planit Programor dhe të Produksionit (planit PP) të miratuar në mbledhjen e Këshillit;
3. Miratimi i Raportit për punën e Komisionit në gjashtë muajt e kaluar;
4. Të ndryshme

I

Procesverbali nga mbledhja e gjashtëmbëdhjetë e rregullt e Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm. (4 vota PËR)

II

Mirheta Gaçeviq në konton e ndryshimeve të planit PP tha se është i dukshëm komenti për emisionin, "Gllasovi iz susjedstva", që ishte planifikuar në kuadër të Redaksisë të programit në gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale, dhe cekej se "emisioni nuk do të realizohet sepse nuk është vendosur komunikimi me Sarajevën, Shkupin e Prishtinën". Ajo që atë e interesoi në komentin e cekur ishte se kush e shkroi këtë koment, që ka të bëjë me atë se kush nuk ka pasur mundësi të vendos komunikim me Sarajevën, Shkupin e Prishtinën dhe shkaqet se pse nuk është vendosur një komunikim mi tillë, duke theksuar se një emision i tillë është shumë i vlefshëm sepse krahas saj, emetohet praktikisht vetëm një emision në gjuhët e popujve pakicë.

Admir Adroviq lidhur me këtë tha se një koment i tillë është joserioz dhe theksoi të njëjtën problematikë, e që ka të bëjë me çështjen se çka do të thotë se nuk është vendosur komunikimi dhe kush është dashtë që ta vendos, konsideron se do të duhej të dorëzohet arsyetim adekuat për këtë.

Tripo Matijeviq u pajtua me të gjitha të cilat u ceken, duke theksuar se komenti nuk është i plotë dhe se në bazë të tij nuk mund të gjykohet sepse nevojiten informata shtesë. Gjithashtu tha se është pak i shokuar me faktin se po zvogëlohet programi edhe ashtu modest, sepse krahas mos emetimit të "Glasovi iz susjedstva", po zvogëlohet numri i emetimeve të Ditarit në gjuhën shqipe. Ai do të kërkonte nga ana e Këshillit që tu dorëzohen shkaqet e zvogëlimit të numrit të emisioneve si dhe plotësimi i komentit të cekur. Gjithashtu ai konsideron se është momenti i duhur që të përsëritet çështja e vizitave në serviset publike rajonale.

Veron Halili ishte pa koment.

Admir Adroviq pastaj ceku se ka vërejtur së fundi emisionin i cili emetohet në kuadër të Redaksisë së programit të pakicave tjera dhe bashkësive, në pyetje është "Mramori znamenitih crnogoraca". Pyetja e

tij ka të bëjë me se “Çka nënkuptojnë me atë malazez (crnogoraca)”, dhe nëse ata janë qytetarë të Malit të Zi, malazez si komb, e nëse bëhet fjalë për malazez si komb, a thua e ka vendin një emision i tillë në Redaksinë e programit për pakicat tjera, sepse konsideron se në këtë rast nuk e ka vendin aty. Mirheta Gaççviq komentoi se edhe ajo vetëm tani e ka vërejtur emisionin e cekur dhe se këtë çështje do të ishte mirë ta linin për mbledhjen e ardhshme, kur të jenë prezent përfaqësuesit e Redaksisë, me çgjë u pajtuan edhe anëtarët tjerë.

Për sa i përket vizitave studimore të cilat i pemendi anëtari i Komisionit, Tripo Matijeвиq, anëtarët e pranishëm u pajtuan se do të duhej që deri në fund të vitit të tentohet të sigurohet së paku një vizitë dhe se ata do ta dorëzojnë një formë plani të vizitës, kurse buxhetin për këtë vizitë do të duhej ta caktojë RTMZ, kurse kryetarja Mirheta Gaççviq do ta formulojë iniciativën lidhur me këtë, të cilën edhe zyrtarisht do të ia dërgojë Këshillit të RTMZ, dhe në bazë të kë[saj do të shohin se çka do të bëjnë më tej.

III

Mirheta Gaççviq tha se të gjithëve në e-mail u ka dërguar Raportin për punën e Komisionit për gjashtë muajt e kaluar, të gjitha Procesverbalet janë miratuar në mbledhje dhe se në fund do të analizojnë të gjitha ato të cilat i kanë punuar dhe çka kanë arritur si dhe do të definojnë disa qëllime për periudhën e ardhshme.

Tripo Matijeвиq u ndërlihd në deklarin e saj për Raport, me koment se me përmbajtjen e tij pajtohet plotësisht, por është i mendimit se para se ai ti dërgohet zyrtarisht Këshillit, do të duhej të lexohej dhe përmirësohen gabimet eventuale teknike, me çgjë u pajtuan edhe anëtarët tjerë të pranishëm, kurse Mirheta Gaççviq u deklarua se këtë obligim do ta marrë mbi vete, pas u kalua në votim

Raporti gjashtëmuor i punës së Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm. (4 vota PËR)

IV

Anëtarët e Komisionit konstatuan së bashku se krahas Kontratës për afrimin e shërbimeve publike nr. 01-2400 të datës 30.05.2018, i kontraktuar mes RTMZ dhe Qeverisë së Malit të Zi, i cili u është dorëzuar në mbledhjen e mëparshme, të 16 të rregullt të Komisionit, të mbajtur me 26.06.2023, është e domosdoshme të bëhet plotësimi i vetë dokumentacionit, respektivisht tu dorëzohet Propozimi i obligimeve programore i RTMZ, i cili ceket se pjesë përbërëse e vetë Kontratës, e i cili mungon për këtë rast.

Gjithashtu ata kërkuan që përfaqësuesit e Redaksisë së pakicave në gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale, redaktori i Redaksisë dhe gazetarët, të ftohen në mbledhjen e ardhshme të Komisionit.

PROCESVERBALIN E PUNOI
Ballsha Miliq

KRYETARJA E KOMISIONIT
Mirheta Gaççviq